



Qeveria e Kosovës
Vlada Kosova - Government of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë / Kancelarija za Dobro Upravljanje / Office on Good Governance



RAPORT VJETOR PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR ORGANIZATAT JO-QEVERITARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS PËR VITIN 2018

PRILL 2019

PËRMBAJTJA

6	Lista e shkurtesave
8	1. Hyrje
9	1.1 Metodologjia e përdorur
10	2. Të dhëna të përgjithshme për raportimin nga ana e organizatave buxhetore
10	2.1 Raportimi nga Organizatat Buxhetore
11	3. Të dhëna të përgjithshme për mbështetjen financiare publike për OJQ-të në nivel të Ministrive, Komunave dhe Agjencive tjera të pavarura
14	4. Të dhëna për mbështetjen financiare publike për OJQ-të sipas Ministrive, Komunave dhe Agjencive tjera
14	4.1 Të dhënat e përgjithshme për Financimin Publik të OJQ-ve për vitin 2018 sipas organizatave Buxhetore
16	4.2 Mbështetja Financiare për OJQ-të në kuadër të MINISTRIVE
16	4.2.1 Qëllimi i mbështetjes financiare të ofruar nga Ministritë
19	4.2.2 Numri i OJQ-ve përfituese nga Financimi i Ministrive dhe ndarja sipas shumave të mbështetjes financiare
20	4.3 Mbështetja në kuadër të KOMUNAVE
21	4.3.1 Qëllimi i mbështetjes financiare të ofruar nga Komunitat
27	4.3.2 Numri i OJQ-ve përfituese nga Financimi i Komunave dhe ndarja sipas shumave të mbështetjes financiare
28	4.4 Mbështetja financiare publike nga Agjencitë e pavarura dhe institucionet tjera publike
29	5. Konkluzione dhe rekomandime
32	6. Aneksë: lista e përfituesve sipas institucioneve dhe shuma e mbështetjes financiare publike për vitin 2018
32	6.1 Lista e OJQ-ve përfituese nga mbështetja financiare publike në kuadër të Ministrive të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2018
70	6.2 Lista e OJQ-ve përfituese nga mbështetja financiare publike në kuadër të Komunave për vitin 2018
98	6.3 Lista e OJQ-ve përfituese nga mbështetja financiare publike në kuadër të Agjencive dhe organizatave tjera buxhetore për vitin 2018
103	6.4 Raportet e pranuar nga Ministritë dhe Komunitat me informacion sipas kërkesave të rregullores
226	6.5 Lista e mënyrës së lokimit sipas kolonës 3A në tabelat në aneksin 6.4

LISTA E SHKURTESAVE

AACK	AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL I KOSOVËS
AKP	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
ARH	AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE
ARSHU	AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
ASHAK	AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ASHNA	AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR
ASHNA	AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR
IGJK	INSTITUTI GJYGJËSOR I KOSOVËS
KPMM	KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE
KQZ	KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE
KRPP	KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK
MAP	MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE
MAPL	MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
MASHT	MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MBPZHR	MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MD	MINISTRIA E DREJTËSISË
MeD	MINISTRIA E DIASPORËS
MF	MINISTRIA E FINANCAVE
MFSK	MINISTRIA E FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS
MI	MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
MIE	MINISTRIA E INTEGRIMIT EVROPIAN
MKK	MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM
MKRS	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT
MKRS	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT
MMPH	MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MPB	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MPJ	MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME
MPMS	MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENJES SOCIALE
MSH	MINISTRIA E SHËNDETËSISË
MTI	MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRISË
MZHE	MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK
OJQ	ORGANIZATA JO-QEVERITARE
SHSKUK	SHËRBIMI SPITALOR KLIKIK UNIVERZITAR I KOSOVËS
UP	UNIVERSITETI I PRISHTINËS
ZKA	ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
ZKM	ZYRA E KRYEMINISTRIT
ZP	ZYRA E PRESIDENTIT
ZRRE	ZYRA E RREGULLATORIT TË ENERGJISË SË KOSOVËS

Fjalë hyrëse nga Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit

Qeveria e Republikës së Kosovës tashmë ka krijuar një praktikë të suksesshme të publikimit të raporteve vjetore për mbështetjen financiare publike për organizatat jo qeveritare. Edhe viti 2018, ka qenë një vit i suksesshëm i bashkëpunimit të institucioneve të Republikës së Kosovës të nivelit qendror dhe atij lokal me organizatat e shoqërisë civile në funksion të implementimit të prioriteteve të tyre. Ky bashkëpunim është në funksion edhe të realizimit të objektivave qeveritare për transparencë, llogaridhënje, përgjegjësi si dhe të përcaktuara me Rregulloren MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve. Githashtu edhe Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 e trajton këtë komponentë si objektivë të veçantë. Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit ka dhënë një kontribut të vazhdueshëm në avancimin e transparencës dhe llogaridhënies në ofrimin e mbështetjes financiare publike për OJQ-të edhe gjatë vitit 2018. Ky kontribut është fokusuar në ofrimin e mbështetjes për zyrtarët publik si dhe për OJQ-të përmes trajnimeve të përbashkëta dhe atyre në vendin e punës, në funksion të zbatimit të përpiktë të rregullore MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Ky raport tregon një përmirësim në implementimin e kësaj rregulloreje, megjithatë, nevojitet një angazhim edhe më i madhinstitucional në rritjen e transparencës dhe implementimin e kësaj rregulloreje. Ky raport ofron një serë rekomandimeshtë cilat Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit do të përkushtohet që bashkërisht me institucionet publike ti realizojë në praktikë.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, inkurajon të gjitha institucionet publike që të forcojnë mekanizmat e tyre me qëllim të implementimit të kërkesave të legjislacionit në fuqi që ka të bëjë me financimin publik të OJQ-ve. Kjo do të mundësojë rritjen e besimit në institucionet publike dhe krijim të partneritetit me organizatat e shoqërisë civile. Zbatimi i procedurave, kriterëve dhe standardeve për transparencë, llogaridhënie dhe konkurrencë do të mundësojnë që objektivat për ardhmen të arrihen.

Sinqerisht,

Habit Hajredini

Drejtör, Zyra për Qeverisje të Mirë – Zyra e Kryeministrit

1. HYRJJE

Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënie së institucioneve publike si dhe në krijimin e besimit të ndërsjellë mes shoqërisë civile dhe institucioneve publike.

Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit për të arritur këtë qëllim, për herë të parë në Kosovë publikoi raportin për mbështetjen financiare publike që përfshinte vitet 2015 dhe 2016, për të vazhduar me publikimin e raportin edhe për vitin 2017.

Raporti mbi mbështetjen financiare publike për OJQ-të për vitin 2018, është raporti i tretë i përgatitur nga Zyra për Qeverisje të Mirë në nivel të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me mbështetjen financiare publike për OJQ-të. Publikimi i Raporteve Vjetore të mbështetjes financiare publike për OJQ-të ka marrë një vlerësim pozitiv nga të gjitha institucionet, shoqëria civile por edhe nga Raporti për vendin i Komisionit Evropian. Kjo përbën një hap pozitiv drejt një transparence më të madhe të financimit publik.”

Nga viti 2017 me aprovimin e Rregullores MF-Nr.04/2017 Kosova ka ndërtuar një sistem me rregulla unike sa i përket financimit publik të OJQ-ve, rregulla këto të cilat përcaktojnë kriteret minimale të ndërlidhura me financimin publik. Rregullorja MF-Nr. 04/2017 krahas obligimeve tjerapërcakton mënyrë të detajuar përgjergjësinë që institucionet publike kanë për raportimin lidhur me financimin publik të OJQ-ve. Rregullorja ka përcaktuar po ashtu rolin e Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit në procesin e përgatitjes së Raportit gjithëpërfshirës të mbështetjes financiare publike për OJQ-të, i cili përgatitet mbi bazën e raporteve të të gjitha institucioneve publike. Prandaj, forma e monitorimit dhe raportimit për mbështetjen financiare publike për OJQ-të sipas kësaj rregulloreje është shumë mirë e strukturuar duke përfshirë edhe të dhënat që duhet të përmbaj raportin vjetor. Bazuar në Nenin 26 të rregullores, të gjitha organizatat buxhetore duhet ta përgatisin raportin e tyre më së largu më 1 mars për vitin paraprak fiskal. Përveç dërgimit të këtij raporti në Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit, Organizatat buxhetore duhet të njëjtin raport ta publikojnë në faqen e internetit të institucionit përkatës. Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë është përgjegjëse të përmbledhë dhe të publikoj raportin gjithëpërfshirës të mbështetjes financiare Publike për OJQ-të i cili duhet të përfshijë çdo lloj mbështetje financiare që u është dhënë OJQ-ve gjatë vitit paraprak në të gjitha njësitë organizative të organizatave Buxhetore në Republikën e Kosovës.

Edhe gjatë vitit 2018 Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Komunitat kanë vazhduar me përkrahjen e projekteve të Organizatave Jo-Qeveritare në fusha të ndryshme, me prioritet për Institucionet e Republikës së Kosovës dhe shoqërisë kosovare. Kjo mbështetje financiare e projekteve të OJQ-ve kishte për qëllim rritjen e bashkëpunimit me shoqërinë civile, veçanërisht me Organizatat Joqeveritare. Krahas kësaj, Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit me ndihmën e Donatorëve ka punuar me shumë Organizata Buxhetore për të forcuar kapacitetet e tyre në implementimin e kërkesave të kësaj rregulloreje, duke përfshirë trajnimet e përbashkëta dhe trajnimin në vendin e punës. Këto trajnime u zhvilluan me përkrahjen e Projektit të Asistencës Teknike të Komisionit Evropian “Përkrahje për Implementimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile”.

Që nga data 1 korrik 2017 kur ka hyrë në fuqi Rregullorja të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara tëveprojnë konform kërkesave të saj sa i përket financimit publik të OJQ-ve.

Raporti edhe i këtij viti vë në dukje nevojën për përmirësim të kapaciteteve institucionale për të vepruar në përputhje me kërkesat e reja, duke theksuar se *“disa ministri dhe komuna ende nuk janë të gatshme për të përmbushur detyrimet sipas rregullores .”*dhe se *“ende ka mung-*

esë të kapaciteteve teknike për të ekzekutuar në mënyrë efektive buxhetin e caktuar në pajtim me rregulloret dhe procedurat e përcaktuara”¹

Gjatë këtyre dy viteve Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ka punuar me institucionet publike në ngritjen e kapaciteteve të tyre në zbatimin sa më të mirë të kësaj rregulloreje dhe do të vazhdoj të punoj në këtë drejtim.

Raporti mbi mbështetjen financiare publike për OJQ-të për vitin 2018, është raporti i tretë i pagatitur në nivel të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me mbështetjen financiare publike për OJQ-të **dhe mbulon të gjitha organizatat buxhetore** të nivelit qendror dhe lokal të cilat në çfarëdo forme kanë ofruar mbështetje financiare për organizatat jo qeveritare. Nga të dhënat e mbledhura prej Organizatave Buxhetore, web faqet e Organizatave Buxhetore si dhe nga puna e drejtpërdrejtë që ka zhvilluar Zyra për Qeverisje të Mirë /Zyra e Kryeministrit në ngritjen e kapaciteteve të Organizatave Buxhetore, mund të **vërehet një avancim në aplikimin e rregullores sa i përket financimit publik të OJQ-ve**. Megjithatë, ka ende organizata buxhetore, të cilat nuk zhvillojnë thirrje publike dhe nuk ofrojnë mbështetjen financiare publike për OJQ-të sipas kërkesave të Rregullores. Gjithashtu ndonëse rregullorja është e qartë në kërkesat e saja, disa nga organizatat buxhetore edhe pse kanë publikuar thirrje publike, të njëjtat nuk kanë qenë plotësisht në linjë me kërkesat e rregullores.

Sa i përket raportimit dhe publikimit të informatave lidhur me financimin publik të OJQ-ve për vitin 2018 nga ana e Organizatave Buxhetore, ka mjaft hapsirë për përmirësim të gjendjes, sepse edhe në kohën kur ky raport gjithëpërfshirës është përgatitur, disa organizata buxhetore ende nuk i kanë publikuar raportet mbi financimin publik të OJQ-ve për vitin 2018 dhe nuk i kanë dërguar te Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në përputhje me kërkesat e Rregullores.

Si rrjedhojë edhe këtë vit, Zyra për Qeverisje të Mirë, me qëllim të informimit sa më të mirë të publikut lidhur me mbështetjen financiare publike për Organizatat jo Qeveritare, ka bashkëpunuar me Ministrinë e Financave, gjegjësisht me Thesarin. Kjo është bërë në mënyrë që të përgatitet një raport sa më gjithëpërfshirës bazuar në pagesat që organizatat buxhetore kanë ekzekutuar për përfituesit të cilët janë regjistruar në Thesar si Organizata Jo-Qeveritare. Në aneksin 6.4 janë paraqitur të dhënat e raportuara nga ana e Organizatave Buxhetore, pra të dhënat sipas kërkesës së Rregullores për ato organizata që kanë përmbushur detyrimin Ligjor për Raportim. Publikimi i këtij raporti vlerësojmë se do të kontribuojë rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike dhe në të njëjtën kohë do të ketë ndikim në përmirësimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile në Republikën e Kosovës.

1.1 Metodologjia e përdorur

Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, sipas Rregullores iu është drejtuar me kërkesë të gjitha organizatat buxhetore që të përgatisin dhe dorëzojnë raportet mbi financimin publik të OJQ-ve për vitin 2018. E njëjta kërkesë i është drejtuar edhe nivelit lokal përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Pasë parasyshë që një numër i madh i organizatave buxhetore nuk kanë arritur të dërgojnë raportet e tyre në përputhje me kërkesat e Rregullores, Zyra për Qeverisje të Mirë krahas të dhënave të përcjella prej organizatave që kanë raportuar ka përdorur si të dhëna plotësuese dhe krahasuese edhe bazën e të dhënave të ofruara nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave. Prandaj, Raporti për mbështetjen financiare publike për OJQ-të në kuadër të institucioneve të Republikës e Kosovës për vitin 2018, është përgatitur mbi bazën e të dhënave të siguruara nga organizatat buxhetore dhe Ministria e Financave. Të dhënat e siguruara nga Thesari përfshijnë të gjitha pagesat që janë ekzekutuar brenda periudhës 1 janar - 31 dhjetor të vitit përkatës për furnitorët e regjistruar në Thesar si Organizata Jo-Qeveritare.

¹ Po aty.

Duke pasur parasysh se të dhënat e siguruar nga Ministria e Financave janë mbi bazën e pagesave dhe jo të projekteve apo programeve të financuara, për përgatitjen e këtij raporti të dhënat e tilla janë përpunuar në atë mënyrë që nëse një OJQ ka pranuar shuma të ndryshme të parave brenda një viti nga i njëjti institucion apo nga departamente të ndryshme të të njëjtit institucion, ato janë mbledhur dhe janë paraqitur si një shumë e vetme financiare për të njëjtën OJQ brenda vitit përkatës në anekset e bashkangjitura të këtij raporti. Ndonëse, projekte të caktuara në kuadër të institucioneve të ndryshme mund të jenë aprovuar me shuma më të larta se sa ato të paraqitura në këtë raport pasi jo të gjitha shumatat e aprovuara mund të jenë ekzekutuar brenda vitit fiskal, për të ruajtur njëtrajshmërinë e metodologjisë së të dhënave të përdorura.

Përveç kësaj, Zyra për Qeverisje të Mirë ka analizuar edhe web faqet e institucioneve publike, për të analizuar thirrjet publike, përmbajtjen e tyre dhe rrjedhën e procesit të një thirrje publike për financimin e OJQ-ve. Janë analizuar në mënyrë të veçantë të dhënat nga Institucionet që kanë raportuar dhe janë paraqitur në aneksin II të këtij raporti. Në pjesën e parë të raportit është punuar me të dhënat nga Thesari, për të mundësuar një paraqitje gjithëpërfshirëse dhe krahasuese me vitet paraprake.

Në përgatitjen e këtij raporti, Zyra për Qeverisje të Mirë në ZKM është mbështetur nga projekti i Asistencës Teknike të financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë *“Përkrahje për Implementimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile” të cilat nuk mbajnë përgjegjësi për saktësinë e shënimeve përkitazi me emërtimet e OJQ-ve, apo faktin nëse emrat e tyre janë të regjistruarasi të tilla në Thesar.*

2. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR RAPORTIMIN NGA ANA E ORGANIZATAVE BUXHETORE

2.1 Raportimi nga Organizatat Buxhetore

Rregullorja MF-Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, në Nenin 26 ka përcaktuar qartë detyrimin e të gjitha organizatave buxhetore për raportim vjetor për mbështetjen financiare publike për OJQ-të.

Vlen të theksohet se Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën së Kryeministrit në përputhje me kërkesat e Rregullores mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve përveq kërkesës për raportim ka organizuar edhe dy sesione informuese për zyrtarët përgjegjës për raportim në nivelin lokal dhe qendror për të ofruar lehtësira dhe sqarime lidhur me përgatitjen e raportit. Në këto sesione informuese kanë marrë pjesë përfaqësues nga shumë Organizata Buxhetore të nivelit qendror e lokal. Në kërkesën për raportim, Zyra për Qeverisje të Mirë i ka vënë në dijeni udhëheqësit e Organizatave Buxhetore se Rregullorja, mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve MF-Nr. 04/2017, buron nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, prandaj, mos raportimi ose vonesat në raportim përbën shkelje të Dispozitave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Zyra për Qeverisje të Mirë ka ofruar gjithë gatishmërinë e saj që të ofrojë ekspertizën e vet dhe ti mbështesë të gjitha organizatat buxhetore që kanë nevojë në përgatitjen e raportit vjetor.

Krahasuar me vitet paraprake, raportimi është përmirësuar dukshëm, megjithatë ky raport tregon se një numër i madh i organizatave buxhetore nuk kanë dërguar raportin e tyre sipas kërkesave të rregullores. Figura në vijim tregon nëpërqindje numrin e organizatave buxhetore

përfshirë Ministrinë dhe Komunitat sa i përket raportimit ose jo, sipas kërkesave të Rregullores MF-NR-04/2017 për Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.




Figura 1. Të dhëna të përgjithshme sa i përket raportimit nga organizatat buxhetore

Të dhënat sa i përket secilës organizatë buxhetore janë paraqitur në formë specifike në pjesët në vijim të këtij raporti.

3. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË NË NIVEL TË MINISTRIVE, KOMUNAVE DHE AGJENCIVE TJERA TË PAVARURA

Nga të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara mbi financimin publik të OJQ-ve për vitin 2018, mund të konstatojmë se bashkëpunimi me organizatat jo qeveritare në realizimin e prioriteteve të qeverisë në fusha të ndryshme ka vazhduar edhe gjatë vitit 2018. Të dhënat tregojnë se shumë institucione kanë rritje të kuotave të financimit të OJQ-ve.

Gjatë vitit 2018 institucionet e nivelit qendror dhe lokal kanë vazhduar mbështetjen e projekteve dhe aktiviteteve të Organizatave jo-qeveritare duke përfshirë financimin e projekteve specifike apo përkrahjes direkte për OJQ-të dhe projektet e tyre.

Mbi bazën e të dhënave financiare të siguruar për vitin 2018 rezultojnë se mbështetja financiare publike për OJQ-të nga institucionet publike përfshirë Kuvendin, Presidencën, Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë, Agjencitë e Pavarura dhe Komunitat është **22.7 milion euro**. Kjo shumë krahasuar me vitin 2017 është për 6 milion euro më shumë.




Figura 2. Të dhënat mbi financimin publik të OJQ-ve për vitin 2018

Nëse bëjmë një krahasim sa i përket financimit publik për vitin 2018 dhe 2017 shohim një rritje prej rreth 6 milion Euro në tërësi. Kjo rritje vërehet edhe në nivel të institucioneve qendrore dhe atyre lokale. Figura në vijim paraqet në mënyrë krahasuese të dhënat e mbështetjes financiare publike për OJQ-të në Kosovë për vitet 2017-2018 për të gjitha organizatat buxhetore, të ndarë sipas ministrive, komunave dhe agjencive tjera:




Figura 3. Të dhënat krahasuese për financimin publik të OJQ-ve 2017-2018

Gjatë vitit 2018 vërehet një rritje e numrit të përgjithshëm të OJQ-ve që kanë përfituar mbështetje financiare publike nga Organizatat Buxhetore si në nivel të Komunave ashtu edhe në nivel të Ministrive, agjencive dhe institucioneve të pavarura. Në vitin 2018 në nivel të Ministrive kanë pranuar mbështetje financiare 793 OJQ, ndërsa në vitin 2017 mbështetje financiare kishin pranuar rreth 594 OJQ përfituese. Këto të dhëna tregojnë se në vitin 2018 në nivel të ministrive kemi rritje të numrit të OJQ-ve përfituese të mbështetjes financiare publike me rreth 200 OJQ, krahasuar me vitin 2017.

E njëjta rritje e financimit por edhe numri i OJQ-ve përfituese shfaqet edhe në nivel të komunave. Në nivel të komunave numri i OJQ-ve përfituese është më i lartë se sa në nivel të

ministrive. Gjatë vitit 2018 nga buxheti i të gjitha komunave kanë përfituar gjithsej 1023 OJQ për dallim nga viti 2017 sa ishin 813 OJQ. Të dhëna të paraqitura paraqesin çdo formë të mbështetjes financiare e cila ka shkuar për furnitorët të cilët në Thesar janë të regjistruar si Organizata Joqeveritare. Ky numër përbën numrin e OJQ-ve që kanë pranuar mjete nga Organizatat Buxhetore. Megjithatë të njëjtat organizata kanë përfituar shpesh nga më shumë se një Organizatë Buxhetore. Ky dallim nga numri i mësipërm është rreth 150 OJQ në nivel qendror dhe rreth 150 OJQ në nivel lokal të cilat kanë përfituar më shumë se sa nga një Organizatë Buxhetore.

Në kuadër të agjencive tjera, të cilat kryesisht i raportojnë Kuvendit, kemi po ashtu një rritje të numrit të OJQ-ve që kanë përfituar nga mbështetja financiare publike. Në vitin 2018 kanë pranuar mbështetje financiare publike 46 OJQ krahasuar me 18 OJQ përfituesse ishin në vitin 2017.

Njëri nga faktorët, që ka mundur të ketë ndikim në këtë rritje mund të jetë edhe rritja e transparencës dhe rritja e numrit të thirrjeve publike në nivel të institucioneve publike sipas rregullores MF-Nr. 04/2017. Kjo pasi, rregullorja për herë të parë ka filluar të aplikohet nga fillimi i vitit fiskal dhe e njëjta ka përcaktuar kriteret dhe procedurat të cilat Organizatat Buxhetore janë të obliguara ti respektojnë me rastin e ofrimit të mbështetjes financiare publike për OJQ-të. Në anën tjetër edhe të kuptuarit e rregullores është rritur në mesin e organizatave buxhetore, ndonëse ende shihen sfida të shumta në zbatimin e saj. Prandaj, rritja e numrit të OJQ-ve përfituese të mbështetjes financiare mund të interpretohet edhe si një shenjë e fillimit të respektimit të kriterëve dhe procedurave të parapara me këtë rregullore.

Figura në vijim paraqet në mënyrë krahasuese numrin e përfituesve të mbështetjes financiare publike nga ministrinë, komunat dhe agjencitë tjera për vitet 2017-2018:




Figura 4. Numri i OJQ-ve që kanë pranuar mjete financiare nga organizatat buxhetore 2017-2018

4. TË DHËNA PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE PËR OJQ-TË SIPAS MINISTRIVE, KOMUNAVE DHE AGJENCIVE TJERA

4.1 Të dhënat e përgjithshme për Financimin Publik të OJQ-ve për vitin 2018 sipas organizatave Buxhetore

Në tabelën në vijim janë të Përfshira Organizatat Buxhetore që bazuar në të dhënat gjatë vitit 2018 kanë kryer pagesa tek ndonjë furnitor, i cili në të dhënat e thesarit është regjistruar si OJQ. Shuma përfshinë të gjitha pagesat e kryera gjatë vitit fiskal, nga data 1 janar deri më 31 dhjetor 2018. Këto të dhëna janë të ndërlidhura me pagesat, të paraqitura në anekset e këtij raporti, që përfshijnë listën e përfituesve.

Nr.	Emri i Organizatës Buxhetore	Shuma e Pagesave nga organizata tek Operoret e Regjistruar në Thesar si OJQ në vitin 2018
1	ZYRA E KRYEMINISTRIT	2,151,619.90
2	VENDIME TË QEVERISË NGA REZERVA SHTETËRORE	959,400.00
3	ZYRA E PRESIDENTIT	152,905.48
4	MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE	495,360.00
5	MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL	47,023.00
6	MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	807,109.31
7	MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	366,490.56
8	MINISTRIA E DIASPORËS	69,652.00
9	MINISTRIA E DREJTËSISË	0.00
10	MINISTRIA E FINANCAVE	5,720.00
11	MINISTRIA E FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS	251,113.0
12	MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS	21,470.43
13	MINISTRIA E INOVACIONIT DHE NDERRMARRESISË	1,796,421.83
14	MINISTRIA E INTEGRIMIT EVROPIAN	24,379.01
15	MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	4,482,477.42
16	MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	103,938.00
17	MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENJES SOCIALE	1,164,795.00
18	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	133,515.90
19	MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME	1,249.00
20	MINISTRIA E SHËNDETËSISË	510,803.60
21	MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIËS	1,053.00
22	MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK	35,495.00
23	MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL	87,456.00
24	MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM	129,239.00
25	DEÇAN	34,150.00
26	DRAGASH	104,370.00
27	FERIZAJ	1,063,444.00
28	FUSHË KOSOVË	624,598.00
29	GJAKOVË	241,473.63
30	GJILAN	512,563.00
31	GLLOGOC	104,429.65
32	GRAÇANICË	199,664.34
33	HANI I ELEZIT	27,450.30
34	ISTOG	181,490.40

35	JUNIK	6,458.40
36	KAÇANIK	108,901.92
37	KAMENICË	356,375.00
38	KLINË	74,460.00
39	KLLOKOT	8,210.00
40	LEPOSAVIQ	9,761.00
41	LIPJAN	141,165.00
42	MALISHEVË	326,936.41
43	MAMUSHË	131,650.70
44	MITROVICA VERI	119,350.00
45	MITROVICË	475,424.00
46	NOVO BËRD	16,935.00
47	OBILIQ	103,151.90
48	PARTESH	12,583.70
49	PEJË	214,035.00
50	PODUJEVË	182,856.00
51	PRISHTINË	568,494.20
52	PRIZREN	686,677.45
53	RAHOVEC	234,513.47
54	RANILLUG	13,376.60
55	SHTËRPECË	18,020.00
56	SHTIME	143,364.40
57	SKENDERAJ	273,309.00
58	SUHAREKË	524,863.00
59	VITI	327,386.70
60	VUSHTRRI	263,523.00
61	ZUBIN POTOK	0.00
62	ZVEÇAN	55,147.83
63	KUVENDI	92,509.24
64	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT	13,756.00
65	AGJENCIA KOSOVARE PER KRAHASIM DHE VERIFIKIM TE PRONES	750.00
66	AKADEMIA E DREJTESISË	250.00
67	AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS	560.00
68	AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL I KOSOVËS	80.00
69	AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE	440.00
70	AUTORITETI RREGULLATOR I KOMUNIKIMEVE ELEKTR. DHE POSTAR	530.00
71	GJYKATA KUSHTETUESE	2,547.00
72	INSTITUCIONI I AVOKATIT TE POPULLIT	4,536.00
73	KESHILLI GJYQESOR I KOSOVES	587.00
74	KËSHILLI PAVARUR MBIKQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS	160.00
75	KESHILLI PROKURORIAL I KOSOVES	1,251.00
76	KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE	6,520.15
77	KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK	135,131.00
78	SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITAR I KOSOVËS	3,840.00
79	UNIVERSITETI I PRISHTINËS	141,840.34
80	ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT	1,833.00

4.2 Mbështetja Financiare për OJQ-të në kuadër të MINISTRIVE

Të dhënat e paraqitura në vijim tregojnë shumën e mbështetjes financiare publike për OJQ-të sipas ministrive përkatëse e cila është ofruar në vitin 2018 dhe e njëjta është krahasuar edhe me vitin paraprak 2017. Pothuajse në të gjitha ministrinë kemi rritje të financimit krahasuar me vitin 2017. Nëse i analizojmë të dhënat e mbështetjes financiare publike, mund të konstatojmë se sa i përket shumës së mbështetjes financiare, institucionet që më së shumti kanë përkrahur projektet e OJQ-ve janë Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Ministria e Arsimit etj.

Duhet theksuar se Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë është një ministri e re, siç është edhe Ministria e Zhvillimit Rajonal, prandaj, financimi në kuadër të këtyre dy ministrive reflekton edhe zvogëlimin e mbështetjes në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, dhe Ministrisë së Bujqësisë, të cilat më herët kanë financuar programe në fushat e ngjashme. Ajo që vërehet më shumë në nivelin qendror është Zyra e Kryeministrit ka shtuar financimin në vitin 2018 për rreth 2 milion euro, MKRS po ashtu me rreth 1 milion euro. Përveç kësaj, një shumë e konsiderueshme e mjeteve financiare janë shpenzuar edhe nga Rezerva shtetërore përmes vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e që përfitues kanë qenë disa organizata jo qeveritare.

Figura 5, në vijim paraqet në mënyrë grafike të dhënat e mbështetjes financiare publike për OJQ-të në nivel të Ministrive, Zyrës së Kryeministrit dhe Zyrës së Presidentit për vitin 2018 të krahasuara me vitin paraprak 2017.




Figura 5. Shuma e mbështetjes financiare publike në nivel të Ministrive 2017-2018

4.2.1 Qëllimi i mbështetjes financiare të ofruar nga ministrinë

Zyra për Qeverisje të Mirë u është drejtuar të gjitha Ministrive për të raportuar mbi mbështetjen financiare publike për OJQ-të të realizuar gjatë vitit 2018. Krahas kërkesës, Zyra për Qeverisje të Mirë kishte përcjellë edhe formularët standard të raportimit. Rreth gjysma e Ministrive kanë raportuar në formatin e kërkuar. Zyra për Qeverisje të Mirë ka analizuar të gjitha raportet e pranuar dhe nga këto raporte ka nxjerrë të dhënat në vijim:

Emri i institucionit	Fusha kryesore e financimit	Mënyra e dhënies së mbështetjes	Nëse raporti i dorëzuar është në linjë me kërkesat e rregullores
Ministria e Diasporës	<ul style="list-style-type: none"> - Arsimi, shkenca - Arti dhe kultura - Aktivitetet e lira - Sporti 	Ministria ka raportuar një thirrje publike përmes të cilës janë financuar projektet	Raporti është dorëzuar i plotësuar në masë të madhe por jo i plotë me të dhënat e kërkuara sipas rregullores.
Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillim i qëndrueshëm; - Ekonomia; - Persona me aftësi të kufizuar; - Arsimi shkenca dhe hulumtimi; - Mjedi dhe natyra; - Trajnime; 	Ministria ka raportuar një thirrje publike përmes të cilës janë financuar projektet.	Raporti është dorëzuar i plotësuar në masë të madhe me të dhënat e kërkuara sipas rregullores.
Ministria e Shëndetësisë	<ul style="list-style-type: none"> - Shëndeti; 	Ministria ka raportuar një thirrje publike përmes të cilës janë financuar projektet.	Raporti është dorëzuar i plotësuar në tërësi sipas kërkesave të rregullores dhe është ndër raportet më të mira të dorëzuara.
Ministria e Zhvillimit Rajonal	<ul style="list-style-type: none"> - Arsimi, shkenca, hulumtimi; - Ekonomia 	Ministria ka raportuar një thirrje publike përmes të cilës janë financuar projektet.	Raporti është dorëzuar i plotësuar në tërësi sipas kërkesave të rregullores dhe është ndër raportet më të mira të dorëzuara.
MPB	<ul style="list-style-type: none"> - Shërbimet sociale - Trajnimet teknike - Punësimi; - Përkrahja për kategoritë e luftës 	Ministria nuk ka raportuar thirrje Publike, por ka raportuar për dy projekte të bashkë financuara	Raporti nuk është dorëzuar sipas kërkesave të rregullores.
MPMS	<ul style="list-style-type: none"> - Shërbimet sociale - Trajnimet teknike - Punësimi; - Përkrahja për kategoritë e luftës 	Ministria ka raportuar një thirrje publike përmes të cilës janë financuar projektet.	Raporti është dorëzuar i plotësuar në tërësi sipas kërkesave të rregullores dhe është ndër raportet më të mira të dorëzuara.
MZHE	<ul style="list-style-type: none"> - Teknologjia informative dhe informacioni - Energjia; - Ekonomia 	Ministria ka raportuar një thirrje publike përmes të cilës janë financuar projektet.	Raporti është dorëzuar i plotësuar sipas kërkesave të rregullores.
ZYRA E KRYEMINISTRIT: ZYRA E KOMISIOERIT PËR GJUHËT, AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE, KOORDINATORI NACIONAL PËR RINI	<ul style="list-style-type: none"> - Të drejtat e njeriut (kryesisht avancimi i përdorimit të gjuhëve zyrtare) - Rinia - Barazia gjinore - Mos diskriminimi 	Zyra për Qeverisje të mirë ka raportuar. Zyra e Komisionerit për Gjuhët ka raportuar Koordinatori Nacional për Rini ka raportuar Agjencia për Barazi Gjinore ka raportuar zyra për Komunitete	Raportet e Zyrave/agjencive në Kuadër të ZKM që janë pranuar janë në linjë me kërkesat e rregullores.

MAPL	-	-	Ministria ka theksuar se nuk ka financuar OJQ-të
MF	-	-	Ministria e Financave ka raportuar se nuk ka ofruar mbështetje financiare Publike, me përjashtim të disa shërbimeve të kontraktuara.
MD	-	-	Ministria ka theksuar se nuk ka financuar OJQ-të.
MKK			Ministria ka theksuar se nuk ka financuar OJQ-të.

Disa nga institucionet që ofrojnë mbështetjen më të madhe publike në nivel të Ministrive megjithatë nuk kanë dorëzuar Raportin e tyre për financimet e vitit 2018.

Edhe pse, të dhënat e siguruara nga Thesari në Ministrinë e Financave dhe po ashtu të dhënat e tjera të qasshme nuk kanë qenë të plota për të kuptuar qëllimin e mbështetjes financiare publike, si dhe objektivat e mbështetjes, nga ato të dhëna që Zyra për Qeverisje të Mirë kishte në dispozicion shihet se mbështetja financiare publike deri diku është në linjë me objektivat strategjike dhe fushën e përgjegjësisë së institucioneve/ministrive që ofrojnë këtë mbështetje financiare publike. Zyra për Qeverisje të Mirë me qëllim të informimit të publikut ka analizuar të dhënat e të gjitha pagesave të kryera nga ana e këtyre institucioneve dhe mbi bazën e atyre të dhënave bazike në dispozicion mund të konstatoj se shumica e Ministrive kanë mbështetur OJQ-të në fushën e tyre të përgjegjësisë dhe prioriteteve. Megjithatë ekzistojnë edhe raste të mbështetjes financiare për OJQ-të, ku përkrahja nuk ndërlidhet drejtpërdrejtë me fushën e përgjegjësisë së institucioneve të cilat ofrojnë mbështetjen financiare.

Në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, e cila është financuesi më i madh i OJQ-ve për vitin 2018 vërehet se mbështetja më e madhe ka shkuar në drejtim të federatave dhe klubeve sportive të sporteve të ndryshme. Federatat dhe klubet sportive në Kosovë janë të regjistruara si OJQ, prandaj edhe në këtë raport janë paraqitur si organizata jo qeveritare. Në kuadër të kësaj ministrie janë mbështetur edhe një numër i madh i OJQ-ve të cilat kanë implementuar projekte nga fusha e kulturës, artit, etj.

Zyra e Kryeministrit, ka mbështetur kryesisht OJQ-të të cilat kanë implementuar projekte në fusha të ndryshme përfitues i të cilave kanë qenë OJQ-të që vijnë nga komunitetet pakicë në Republikën e Kosovës, në veçanti nga komuniteti serb. Në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, janë zhvilluar thirrje publike kryesisht nga Zyra për Çështje të Komuniteteve, Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Komisionerit për Gjuhët, ABGJ dhe Zyra e Koordinatorit Nacional për Rini, Kulturë.

Duke pasur parasysh që mbi bazën e të dhënave në dispozicion, është e vështirë të bëhet një dallim në mes të projekteve dhe programeve të financuara dhe përkrahjes direkte apo kontraktimit për ofrimin e shërbimeve apo blerjes së nga ana e OJQ-ve, në kuadër të këtyre të dhënave janë të përfshira edhe shërbimet e kontraktuara, duke përfshirë shërbimet e edukimit, trajnimit etj, të ofruara nga organizatat e regjistruara si organizata jo-qeveritare. Për shembull shumë nga institucionet qendrore kanë paguar për shërbimet që janë paguar për trajnim si Universitetit Amerikan në Kosovë, i cili është i regjistruar si organizatë jo qeveritare. Po ashtu, trajnimet në fushën e kontabilitetit dhe auditimit janë të përfshira pasi organizatat që i kanë ofruar të njëjtat janë regjistruar si organizata jo-qeveritare.

4.2.2 Numri i OJQ-ve përfituese nga Financimi i Ministrive dhe ndarja sipas shumave të mbështetjes financiare

Në figurën 6 në vijim, është paraqitur numri i OJQ-ve përfituese në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Ministrive dhe Presidencës. Të dhënat e mëposhtme janë të përpunuara në atë mënyrë që ndonëse në shumë raste OJQ-të kanë pranuar më shumë se një herë pagesa nga të njëjtat institucione, në figurën në vijim janë paraqitur të dhënat e përpunuara për numrin e përfituesve në kuadër të secilës ministri, që nënkupton se edhe në rastet kur një OJQ ka përfituar më shumë se një herë brenda vitit, për qëllimet e raportit konsiderohet si një OJQ përfituese. Kjo nënkupton se në kuadër të shumës mund të jetë mbështetur më shumë se një projekt brenda vitit. Po ashtu, në shumë raste është evidentuar se pagesat për OJQ-të në shumë raste kanë ardhur nga kode ekonomike të ndryshme brenda të njëjtës organizatë buxhetore, gjë që vë në dukje planifikimin jo të duhur nga ana e Organizatave buxhetore.

Nga figura 6 shihet se numri më i madh i organizatave përfituese janë në kuadër të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, Zyrës së Kryeministrit, Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Diasporës, Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal. Më së shumti OJQ kanë përfituar nga Ministria e Kulturës rinisë dhe Sporteve, nga e cila kanë përfituar 528 Organizata jo Qeveritare, pasuar nga Zyra e Kryeministrit me 141 OJQ përfitues, Ministria e Zhvillimit Rajonal me 82 OJQ përfituese, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me 88, Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë me 57 OJQ përfitues e kështu me radhë.

Kështu, nga mbështetja financiare publike për OJQ-të, e ofruar në nivel të Ministrive, për vitin 2018 kanë përfituar mbështetje financiare 793 OJQ, dhe siç u theksua më sipër kemi rritje të numrit të OJQ-ve përfituese krahasuar me vitin paraprak për rreth 200 OJQ përfituese. Shumica e OJQ-ve që kanë përfituar mbështetje financiare në vitin 2018, kanë pranuar mbështetje edhe në vitet paraprake. Në figurën në vijim është paraqitur numri i OJQ-ve përfituese nga fondet publike për vitin 2018 sipas secilës ministri, duke përfshirë edhe Zyrën e Kryeministrit si dhe Presidencën. Duhet theksuar se disa nga përfituesit kanë përfituar sipas vendimeve që marrë Qeveria e Republikës së Kosovë, dhe mjetet janë ekzekutuar nga Rezervat Shtetërore, prej Kodit të Rezervave Shtetërore në Thesar. Për qëllime krahasimi kemi përfshirë edhe të dhënat e numrit të përfituesve nga viti paraprak për secilën nga ministrinë dhe institucionet tjera.




Figura 6. Numri i OJQ-ve përfituese sipas Ministrive për vitet 2017-2018

Nga analiza e të dhënave të përpunuara për mbështetjen financiare publike për OJQ-të të

ofruar nga Ministritë e Qeverisë së Republikës së Kosovës mund të vërejmë se kemi një ndryshim të numrit të OJQ-ve sipas shumave të përfitimit nga ana e institucioneve publike. Ndonëse këto shuma janë komulative nga të gjitha ministritë, vërehet se krahasuar me vitet paraprake kemi një tendencë të shumës së përfituar nga ana e OJQ-ve. Po ashtu kemi një rënie të numrit të OJQ-ve që kanë përfituar mjete financiare deri në shumën prej 1000 euro, kurse kemi rritje të konsiderueshme të numrit të OJQ-ve që kanë përfituar shuma mbi 5000 euro.

Në figurën në vijim janë paraqitur në mënyrë grafike të dhënat lidhur me numrin e OJQ-ve përfituese sipas shumave përkatëse, dhe në të njëjtën kohë është bërë krahasime edhe me vitin paraprak.




Figura 7. Numri i OJQ-ve përfituese sipas shumave specifike në kuadër të ministrive

4.3 Mbështetja në kuadër të KOMUNAVE

Në vitin 2018 Kosova ka gjithsej 38 komuna, të cilat janë organizata buxhetore në kuptimin e ligjit për menaxhimin e financave publike. Nga këto 38 komuna, 37 prej tyre kanë dhënë mbështetje financiare publike për Organizatat jo-qeveritare në vitin 2018. Të dhënat tregojnë se në vitin 2018 janë transferuar gjithsej 8,490,563 Euro në llogaritë e Organizatave jo-Qeveritare nga ana e Komunave. Nëse bëjmë një krahasim të shumës së financimit publik për projektet e OJQ-ve nga komunat në vitin 2018 me ato të vitit 2017, vërehet rritje e financimit të Organizatave jo Qeveritare në nivelin komunal me rreth 2.4 milion euro në vitin 2018. Figura në vijim paraqet mbështetjen financiare publike sipas secilës nga komunat për vitin 2018, duke bërë krahasimin me vitin paraprak.




Figura 8. Mbështetja financiare publike për OJQ-të nga komunat 2017-2018

4.3.1 Qëllimi i mbështetjes financiare të ofruar nga komunat

Zyra për Qeverisje të Mirë u është drejtuar të gjitha Komunave përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për të raportuar mbi mbështetjen financiare publike për OJQ-të të realizuar gjatë vitit 2018. Krahas kërkesës, Zyra për Qeverisje të Mirë kapërcjellë edhe formularët standard të raportimit. Vetëm një numër i vogël i komunave kanë raportuar në formatin e kërkuar. Zyra për Qeverisje të Mirë ka analizuar të gjitha raportet e pranuar dhe nga këto raporte ka nxjerrë të dhënat në vijim:

Emri i institucionit	Fusha kryesore e financimit	Mënyra e dhënies së mbështetjes	Nëse raporti i dorëzuar është në linjë me kërkesat e rregullores
Drenas	<ul style="list-style-type: none"> Aktivitetet sportive; Aktivitete kulturore, artistike, Personat me aftësi të kufizuar Shërbime sociale 	<p>janë raportuar 2 thirrje publike, Drejtorati për shëndetësi dhe mirëqene sociale;</p> <p>Drejtorja e Kulturës dhe Sportit</p>	<p>Në disa raste ka pasur edhe mbështetje direkte pa thirrje publike; kryesisht për aktivitetet sportive.</p> <p>Raporti i dorëzuar është në masë të madhe i plotësuar me të dhënat e kërkuara.</p>
Graçanicë	<ul style="list-style-type: none"> Kultura, Rinia Sporti 	<p>Komuna ka raportuar dy thirrje publike përmes të cilës janë financuar projektet.</p> <p>Komuna ka raportuar edhe disa financime direkte të OJQ-ve pa thirrje publike</p>	<p>Raporti është dorëzuar i plotësuar në tërësi sipas kërkesave të rregullores dhe është ndër raportet më të mira të dorëzuara.</p>
Malishevë,	<ul style="list-style-type: none"> Janë mbështetur kryesisht aktivitetet e klubeve sportive; Aktivitete kulturore dhe edukative; 	<p>është raportuar një thirrje publike përmes të cilës kanë përfitur aplikuesit.</p>	<p>Raporti është dorëzuar i plotësuar sipas kërkesave të rregullores;</p>
Mitrovicë	<ul style="list-style-type: none"> Të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve; Personat me aftësi të kufizuar 	<p>Komuna ka raportuar një thirrje publike në fushën e të drejtave të njeriut dhe fëmijëve</p>	<p>raporti është dorëzuar jo i plotë me të dhënat e kërkuara sipas rregullores.</p>

Pejë	<ul style="list-style-type: none"> - Kultura, - Rinia, - Sporti 	Komuna ka raportuar një thirrje publike përmes të cilës janë financuar projektet. Raporti përmban të dhëna vetëm sa i përket Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sporti;	Raporti është dorëzuar i plotësuar sipas kërkesave të rregullores.
Rahovec	<ul style="list-style-type: none"> - Kultura, arti, rinia - Sporti; 	Komuna ka raportuar një thirrje publike; Komuna ka raportuar edhe financime direkte të OJQ-ve përmes vendimeve	Raporti është dorëzuar i plotësuar në masë të madhe sipas kërkesave të rregullores.
Suharekë	<ul style="list-style-type: none"> - Janë mbështetur kryesisht klubet sportive dhe aktivitetet sportive, - Aktivitete kulturore, duke përfshirë edhe aktivitetet rinore; 	Nuk ka pasur thirrje publike dhe mbështetja është dhënë me vendime;	Raporti është dorëzuar pjesërisht i plotësuar
Shtime	<ul style="list-style-type: none"> - Aktivitete sportive; - Aktivitete rinore; - Përkrahje për personat me aftësi të kufizuar - Shërbime sociale; 	Komuna ka raportuar dy thirrje publike; Janë raportuar edhe mbështetje direkte;	Raporti është dorëzuar i plotësuar në masë të madhe sipas kërkesave të rregullores
Vushtrri	<ul style="list-style-type: none"> - Kultura, arti, - Sporti, - Të drejtat e njeriut; - Shërbimet sociale; - Demokracia; 	Komuna ka raportuar një thirrje publike;	Raporti është dorëzuar i plotësuar në masë të madhe sipas kërkesave të rregullores.
Prishtinë		Komuna e Prishtinës ka implementuar disa thirrje publike	Raporti i Komunës së Prishtinës është dorëzuar pas afatit, dhe nuk është dorëzuar në formën standarde të kërkuar.
Podujevë		Komuna e Podujevës ka implementuar një thirrje publike	Raporti i Komunës së Podujevës është dorëzuar pas afatit, dhe nuk është dorëzuar në formën standarde të kërkuar.

Zyra për Qeverisje të Mirë në ZKM duke u bazuar në kërkesat e rregullores MF-Nr. 04/2017, përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar nga komunat veç e veç që të raportojnë lidhur me mbështetjen financiare publike që kanë ofruar gjatë vitit 2018. Megjithatë, edhe përkundër njoftimit për kërkesat ligjore dhe kërkesës që të publikojnë dhe dorëzojnë në Zyrën e Kryeministrit raportet sipas kërkesave të Rregullores jo të gjitha komunat kanë raportuar në formën e kërkuar sipas rregullores MF-Nr. 04/2017. Shumica e komunave nuk kanë dorëzuar raportet në përputhje me kërkesat e rregullores MF-Nr. 04/2017. Edhe këtë vit një numër i komunave, gjithsej 9 komuna kanë raportuar në formën standarde të raportimit, ndërsa të dhënat janë paraqitur në tabelën më sipër.

Përveç, të dhënave të raportuara nga ana e komunave, Zyra për Qeverisje të Mirë ka analizuar edhe të dhënat nga Thesari në Ministrinë e financave, për të nxjerrë një raport sa më gjithëpërfshirës lidhur me mbështetjen financiare publike për OJQ-të. Nga këto të dhëna të analizuara vërejmë se kryesisht, në nivel komunal kontraktimi është bërë në mënyrë direkte, dhe mbi bazën e kërkesës së organizatave jo-qeveritare. Në shumë raste mbështetja është dhënë edhe me vendime të Kuvendit Komunal të komunave përkatëse. Sa i përket qëllimit të mbështetjes financiare kryesisht ajo ndërlidhet me sportin, kulturën, përkrahje për OJQ-të të

cilat promovojnë zhvillimin lokal etj.

Edhe gjatë vitit 2018 nga analiza e të dhënave në dispozicion, si dhe të dhënave të raportuara vërehet se komunat kryesisht kanë mbështetur organizatat jo-qeveritare të cilat veprojnë në nivel komunal, pra brenda territorit të komunës që ofron mbështetjen. Megjithatë, disa organizata jo-qeveritare që ushtrojnë veprimtarinë në një numër më të madh të komunave kanë përfituar nga më shumë se sa një komunë në Republikën e Kosovës. Sidoqoftë, nga disa prej komunave janë financuar edhe OJQ-të të cilat ushtrojnë veprimtarinë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, në veçanti OJQ-të që merren me sport si dhe ato të cilat kanë për qëllim të mbështesin grupe të caktuara në nevojë të shoqërisë, duke përfshirë personat me nevoja të veçanta, OJQ-të që janë duke ofruar shërbime shëndetësore, OJQ-të të cilat janë duke implementuar projekte të cilat janë të bashkë-financuara me donatorët etj.

Ndonëse shumë komuna nuk kanë raportuar, nga analiza e të dhënave të publikuara në web faqet e tyre vërehet se ato kanë shpallur thirrje publike sipas kërkesës së rregullores. Kjo nënkupton se rregullorja ka gjetur zbatim në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Megjithatë, mbetet ende punë për të përmirësuar thirrjet publike dhe procesin e përzgjedhjes së përfituesve të fondeve publike.

Zyra për Qeverisje të mirë ka analizuar thirrjet publike të disa nga Komunave që kanë ofruar mbështetje të madhe financiare si për nga shuma ashtu edhe për nga numri i përfituesve dhe ka vërejtur se ende ka shumë hapësirë për përmirësimin e zbatimit të dispozitave të rregullores. Ndonëse në këtë pjesë është paraqitur një analizë e të dhënave të Komunës së Prishtinës si njëra nga Komunat që ka ofruar mbështetjen më të madhe publike për OJQ-të, sfida të ngjashme hasen në pothuajse të gjitha komunat dhe institucionet tjera që kanë ofruar mbështetje financiare publike për OJQ-të gjatë vitit 2018.

Komuna e Prishtinës, është njëra nga komunat që për nga mbështetja financiare publike zë vendin e parë në nivel të komunave, megjithatë, kjo komunë nuk ka dorëzuar raportin e financimit publik të OJQ-ve në përputhje me kërkesat e rregullores. Komuna e Prishtinës ka dërguar raportin me vonesë dhe i cili nuk përmban informatat e kërkuara sipas rregullores dhe formularitstandard. Në vijim janë paraqitur disa të dhëna që janë të dukshme nga një analizë e thjeshtë e thirrjeve publike dhe listës së përfituesve të publikuar gjatë procesit të përzgjedhjes së përfituesve. Nga të dhënat e publikuara në faqen e internetit të Komunës së Prishtinës, rezulton se gjatë vitit 2018 janë publikuar katër thirrje publike, me një shumë maksimale të financimit prej 550,000 euro. Nga analiza e thirrjeve publike mund të konstatohen këto gjetje:

Anët pozitive

- *Janë hapur katër thirrje publike, duke përcaktuar fushat prioritare, si dhe aktivitetet të cilat do të mbështeten përmes thirrjeve publike;*
- *Janë përcaktuar kushtet për aplikim, duke përfshirë edhe afatet dhe mënyrën e aplikimit;*
- *Janë hapur thirrje publike edhe për sa i përket emërimit të anëtarëve të jashtëm të komisionit vlerësues;*
- *Janë publikuar rezultatet paraprake dhe përfundimtare në faqen e internetit të komunës;*

Sfidat:

- *Thirrja publike ka përcaktuar minimumin dhe maksimumin e financimit për projekt, megjithatë, nuk ka treguar numrin e përfaqësuesve të OJQ-ve përfituese;*
- *Diferenca në mes të shumës minimale dhe maksimale për projekt ka qenë tejte e madhe 300 euro minimumi dhe 10,000 euro maksimumi.*

- Nga rezultatet e publikuara, të përfituesve shihet që krahasuar me shumën që kanë aplikuar, pothuajse të gjithë aplikuesit kanë përfituar vetëm një shumë simbolike. Kjo ngre dyshime se projektet me të cilat kanë aplikuar aplikuesit nuk kanë mundur të realizohen në tërësi me buxhetin që u është dhënë. Projektet nëse kanë qenë në linjë me kërkesat e thirrjes së dashur të financohen në tërësi. Rregullorja lejon korrigjim të shumës vetëm nëse buxheti nuk është real. Por, organizatat buxhetore nuk kanë të drejtë të mbështesin projektin si tërësi dhe të financoj atë me një shumë minimale. Ndërsa nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë fare në aktivitete. Ndërhyrja e tillë e cenon njërin nga parimet bazë të rregullores, atë të konkurrencës.
